

**VENDIM**  
**Nr. 58, datë 31.3.2022**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË  
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA”, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw**

*(ndryshuar me vendimin nr. 125, datë 4.4.2023)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 411 prot., datë 28.3.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja” me kapacitet të instaluar 1980 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 14.02.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/3 prot., datë 14.2.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pika 4.1.1: plotësuar;

- të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, neni 9, pika 4.1.2: plotësuar;

- dokumentacioni teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5., germa “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Në përfundim të afatit të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 23.1.2023), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë lejen nga baseni ujor me afat të rinovuar, brenda datës 23.1.2023.

- Në lidhje me VNM-në paraprake të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), me nr. 2888 prot., datë 9.12.2016, për HEC-in “Terfoje” me kapacitet të instaluar 1980 kw, vlerësojmë se kjo VNM konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim, në kuptim të interpretimit të dërguar në ERE nga AKM-ja, me *e-mail*-in zyrtar të datës 18.2.2020. Sa i përket kryerjes së punimeve ato janë dokumentuar nga ana e shoqërisë nëpërmjet faturave tatimore të shitjes dhe bilanceve të investitorit që ka kryer punimet e HEC “Terfoje”.

- Kontrata nr. 1173 rep., nr. 510/3 kol., datë 30.5.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Terfoje”, me kapacitet prodhues 1.980 mw, në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit dhe të përroit të madh, degë e lumit Bushtricë, Bashkia Kukës, qarku Kukës, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoje”; me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar brenda datës 18.4.2023.*

3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.

4. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**